



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 5810 Prot.

Ballsh, më 21.11.2023

PROJEKT VENDIM

Nr. 40, Datë 21.11.2023

PËR

MIRATIMIN E ZHDËMTIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TË BANORËVE
TË FSHATIT HEKAL QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION I SEGMENTIT RRUGOR PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS-
RRUGA E RE LEVAN TEPELENË”

- KËSHILLIT TË BASHKISË

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, të Vendimit nr. 18, datë 23.03.2021 të Këshillit të Bashkisë Mallakastër “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër me objekt “Rikonstruksion i rrugës nga Parku Arkeologjik Bylis- Rruga e Re Levan Tepelenë” dhe miratimin në parim për shpronësimin e pronave që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti”, të marrëveshjes së bashkëpunimit datë 05.03.2021, ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër me objekt “Rikonstruksioni i rrugës nga Parku Arkeologjik Bylis – Rruga e Re Levan- Tepelenë”, të VKM-së nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, si dhe të Urdhërit të Brendshëm nr. 21, datë 28.01.2023 “Për ngritjen e komisionit për konstatimin e pasurive të paluajtshme të banorëve që preken nga zbatimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës nga Parku Arkeologjik Bylis – Rruga e Re Levan- Tepelenë”,

PROPOZOJ:

1. Miratimin zhdëmtimit të dëmeve të pasurive të paluajtshme të banorëve, fshati Hekal, Njësia Administrative Hekal, Bashkia Mallakastër, që preken nga zbatimi i projektit “Rikonstruksion i segmentit rrugor Parku Arkeologjik Bylis- Rruga e Re Levan - Tepelenë”, në vlerën 2 821 704 (dy milion e teteqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekë sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Vlera e zhdëmtimit të pasurive të paluajtshme të banorëve, fshati Hekal, Njësia Administrative Hekal, Bashkia Mallakastër, që preken nga zbatimi i projektit “Rikonstruksion i segmentit rrugor Parku Arkeologjik Bylis- Rruga e Re Levan - Tepelenë”, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.

Konceptoi: A.Heqimaj

Pranoi: N.Sakaj

Miratoi: L.Saliaj

K RYETAR
Qerim Ismailaj

